



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA QËNDRORE**

Nr. 465 Prot.

Tiranë, më 16.03 2020

URDHËR

Nr. 30 datë 16.03 2020

PËR

TRIAZHIMIN E PACIENTËVE NGA MJEKU I FAMILJES

Në zbatim të VKM nr. 419, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", të Urdhërit nr. 18, datë 17.01.2019, nr. Prot. 321 të MSHMS "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Funksionimit dhe Organizimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", të Urdhër Nr. 81, datë 10.02.2020 "Për miratim të protokolleve dhe algoritmeve për parandalimin e sëmundjes COVID – 19 në vend" të Minsitrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr. prot 744, datë 10.02.2020 dhe më specifikisht të pikës 2 të tij, të Urdhër Nr.159, datë 11.03.2020 "Për kufizimin e lëvizjes së pacientëve , shoqëruesve dhe/ose familjarëve dhe organizimin e shërbimeve në institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryen vizita dhe konsulta ambulatorë" të Minsitrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

URDHEROJ

1. Të gjithë dhënësit e shërbimit shëndetësor publik parësor, mjekë të përgjithshëm/mjekë familje të qendrave shëndetësore në vend, të komunikojnë me pacientët e tyre (ose familjarët) për të informuar se do të jetë personi i kontaktit (nëpërmjet telefonit) në rast se paraqesin probleme shëndetësore si dhe për problemet e tyre kronike.
2. Mjeku i përgjithshëm / Mjeku i familjes, kryen triazhimin për të gjithë pacientët që e kontaktojnë me telefon sipas skedës Triazhi COVID - 2019 të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (bashkëlidhur këtij Urdhëri),
3. Mjeku i përgjithshëm / Mjeku i familjes, pas triazhimit të pacientit, për rastet që gjykon të domosdoshme, kontakton numrin 127 të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore për menaxhimin e rastit.
4. Marrjen e masave të për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve në institucionet shëndetësore publike

5. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri dhe njoftimin e të gjithë ofruesve të shërbimit shëndetësor publik parësor.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Mirela Cami
Mirela Cami





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE

Data: __, __, 2020

Nr i skedës: _____

Ora e thirrjes: _____

Mjeku që pret thirrjen: _____

Rast i brendshëm (brenda vendit):

PO

JO

Nuk dihet

Nëse po, adresa se ku: _____

Rast i jashtëm (ardhur nga jashte vendit):

PO

JO

Nuk dihet

Triazhi telefonik për rastet e dyshimta me COVID-2019 në aeroport, porte dhe pikat kufitare në Republikën e Shqipërisë

Aeroporti/porti/pika kufitare _____

Vendi i origjinës së udhëtimit _____

Vendi tranzit _____

Numri i udhëtarëve në bord avioni/autobuzi/makinë me personin/at e sëmurë _____

Të dhënat personale

Emri: _____

Mbiemri: _____

Datëlindja _____ ose viti i lindjes: _____

Gjinia: _____

Adresa: _____

Rezidenca: _____

Vendqëndrimi (bashkia, komuna, adresa) në Shqipëri _____

Motivi i Udhëtimit _____

Nr.i telefonit _____

Triazhi telefonik për rastet e dyshimta me COVID-2019

Temperaturë PO JO Nuk dihet

Ethe PO JO Nuk dihet

Djersitje PO JO Nuk dihet

Të vjella PO JO Nuk dihet

Diarre PO JO Nuk dihet

Vështiresi në frymëmarrje PO JO Nuk dihet

Kollë PO JO Nuk dihet

Rinit(sekrecione) PO JO Nuk dihet

Teshtimë PO JO Nuk dihet

Dhembje koke PO JO Nuk dihet

Lodhje PO JO Nuk dihet

Të tjera _____

Lëvizja e pacientit në muajin e fundit

Vendi i qëndrimit _____

Kohëzgjatja e qëndrimit _____

Udhëtimet e fundit (vendet ku ka qenë brenda 14 ditëve të fundit) _____

Vendi nga vjen 24 orë përpara mbrritjes _____